

FJALA E DEPUTETIT TOMOR ALIZOTI

E HENE 14 SHTATOR 2023

Dua të flas dy fjalë, meqenëse u ndryshua qeveria dhe është bërë rend dite që ndryshohen qeveritë. Më bën përshtypje një gjë: në 32 vjet demokraci, grupet parlamentare votojnë ende të gjithë rresht, si një repart ushtarak. Së pari, ky është një dëm për Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste, e cila është pjesë e politikës shqiptare, ku vlen demokracia. Për 32 vjet nuk doli një person që të thotë diçka kundër, ku një pjesë e qeverisë janë pothuajse njerëz anonimë, janë jopolitikë dhe është e drejta e çdo njeriu, i cili bën politikë, të ketë poste të larta politike dhe qeveritare. Më bën shumë përshtypje që nuk pati një njeri t'i thotë Kryeministrit të Shqipërisë, i cili fatkeqësisht e ka kthyer partinë tuaj në KPD-në e famshme, që e ka pasur traditë kjo parti, t'i bënte një kritikë se nga vijnë këta ministra! Ka njerëz anonimë në qeveri, që nuk kanë kërkuar asnjë votë për Partinë Socialiste. Pra, e them këtë në prizmin e demokracisë në Shqipëri. Numri 2 është një numër shumë shqetësues... Fatkeqësisht, ai nuk ju pyet as ju si Kryetare parlamenti, asnjë tjetër, por e ka kthyer partinë tuaj në një repart ushtarak (edhe partia jonë po kalon në një kaos politik, por të paktën nuk jemi një parti si repart ushtarak). Imagjiloni, ka bërë që një pastor, i cili duhej të ishte kritik, se beson në Zot, të vendoset në rresht dhe të fillojë nga mëngjesi deri në darkë dhe të lavdërojë Kryeministrin. Kjo është tragjedi! Një njeri që beson në Zot, ka shkuar te Marks, te materializmi! Kjo vlen më shumë për ju, por edhe për të gjithë ne. Edhe PD-ja ka bërë gabime dikur, por nuk mund të ndodhë që të ndryshojë qeveria dhe në mbledhje të mos ketë një zë kritik. Ky është regres në demokraci. Ai, partinë tuaj po e kthen në kartel. Shikojeni ju, sepse ju po qeverisni.

Kjo sjell dëm për demokracinë në Shqipëri. Ka ndodhur një gjë, e cila në sytë e mi është lënë edhe nga opozita pak në heshtje, por duhet të jetë rend. Këto gjëra ndodhin vetëm në Amerikën Latine. Pak më parë ka pasur mbjellje të lëndëve narkotike në repartin e Forcave Speciale. Mjaftonte vetëm kjo gjë, për më tepër që është një vend anëtar i NATO-s, që të kishte një revoltë edhe brenda qeverisë, edhe brenda Grupit të PS-së, por edhe tek opozita. Ministri i Mbrojtjes duhet të mbante përgjegjësi. Fatkeqësisht, jemi në situatën që gjysma e qeverisë është në burg. Kryeministri nuk vjen në Parlament. Mendoj se regresi më i madh që ka bërë Shqipëria në këta 32 vjet, është që po vret demokracinë. Gjithsesi, mendoj se situata në Shqipëri do të vështirësohet edhe më shumë. Nuk është vetëm për ne keq, por do të jetë edhe për ju keq. Unë dy fjalë kisha për të thënë në lidhje me përbërjen e qeverisë. Shqipëria duhet të ketë pak më shumë demokraci dhe duhet të ketë shumë më pak servilë brenda partisë. Po e shkatërroni partinë tuaj, po shkatërroni Shqipërinë dhe po shkatërroni gjithçka. Nuk është turizmi thelb i shtetit. Thelbi i shtetit është që të njihni demokracinë, të respektoni institucionet dhe të keni moral politik dhe moral vlerash. Në një parti politike aderohet për të bërë politikë, për të pasur identitet politik, jo për të qenë servil i shefit dhe për t'u bërë ministër. Nuk mund të udhëhiqet, nuk mund të jetë gjysma e qeverisë me njerëz anonimë.

Faleminderit!